

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. ALBANA BOKSI

04/05/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 04.04.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Boksi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 05.04.2019 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Albana Boksi, gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues e kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj. Firdes Shuli relatore, znj. Pamela Qirko anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.